



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI

Nr. 12392 Prot.

Tiranë, më 04.12 2018

U D H Ë Z I M

Nr. 37, datë 04.12 2018

PËR

“NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 29, DATË 10.09.2018 “PËR VEPRIMTARINË DHE NGARKESËN MËSIMORE TË PERSONELIT AKADEMIK NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË”, I NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 8 të nenit 59, të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë,

U D H Ë Z O N:

Në Kreun II të udhëzimit nr. 29, datë 10.09.2018 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 6 të riformulohet si vijon:

“6. Ngarkesa e plotë mësimore vjetore e personelit akademik me kohë të plotë përmban deri në 3 (tre) lëndë në semestër, në bazë të programeve të përcaktuara nga njësia bazë.”.

b) Në pikën 12, në fund të shkronjës “e” të shtohet:

“Ndjekja e 1 orë praktike spitalore në shkenca mjekësore teknike është 0.5 orë mësimore.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

MINISTRI

LINDITA NIKOLLA

